



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

| | |
|--------------------------------|----------------------------|
| Drejtoria | Drejtoria e Arsimit |
| Periudha raportuese | Prill, 2021 |
| Emri dhe mbiemri i raportuesit | Arbene Aliu, Arbër Gashi |

- ***PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.***

Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit prill të vitit 2021, ka arritur me sukses dhe rezultate të kënaqshme t'i realizojë të gjitha punët dhe detyrat e parapara sipas planit të veprimit me punë dhe detyra të tjera.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas plan programit të Komunës për drejtorinë tuaj.

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja dhe mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit të (DKA-së shkollë) dhe mësimeve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimeve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimeve të dalluar sipas performancës;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Hartimi i politikave dhe rregulloreve për zhvillimin profesional të mësimeve të dalluar sipas performancës;
- Organizimi i punës mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;

- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave, sfidave, vështirësive dhe pengesave;
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësorë në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikimi i nevojave të shkollës për mjetet e TIK-ut;
- Ekipi në fjalë hulumton të arriturat e fundit të përdorimit të teknologjisë arsimore në vend dhe jashtë;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë, kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, ReggioEmilia, Hap pas hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit dhe zbatimit të standardeve të EPSH-së (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – në të përfshihen edhe profesionistë – ekspertë.
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;

- DKA-ja përkrahë NNV-në dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastruktura afirmative për të nxënë efektive;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA-ja harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektive;
- Organizohen ngjarje për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimin nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënlokimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënlokimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimit i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

- Mbështetja dhe mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të Arsimit Parauniversitar në komunën tonë, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale, në këtë kohë pandemie që po kalon vendi.

Sipas dinamikës së planifikuar, përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, gjatë muajit prill kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të Arsimit Parauniversitar.

Pra, në kuadër të mbikëqyrjes dhe mbështetjes profesionale në të gjitha dimensionet që janë paraqitur nevojat.

Kështu që, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit prill të vitit 2021, është realizuar plani i punës.

Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar 64 vizita informuese në lidhje me:

- Informimin rreth ecurisë dhe mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor;
- Respektimit të masave kundër COVID-19, mbajtja e pastërtisë në shkollë;
- Kontrollimi i ditareve (shënimi i orëve online në ditare, klasat VI – XII);
- Vlerësimi i nxënësve – mbyllja e notave për periudhën e dytë;
- Funksionimi i Task-Forcës-dëshmi (procesverbalet e mbledhjeve);
- Të tjera.

Vizitat informuese u realizuan në këto shkolla:

Shkollat e mesme të larta:

- SHML "28 Nëntori",
- SHML "Hoxhë Kadri Prishtina"
- SHML "Abdyl Frashëi"
- SHML "Gjin Gazulli"
- SHML "7 Shtatori"
- SHML "Sami Frashëri"
- SHML "Xhevdet Doda"
- SHML "Gjimnazi Matematik"
- SHML "Ahmet Gashi"
- SHML "Prenk Jakova"
- SHML "Eqrem Çabej"

Shkollat fillore të mesme të ulëta:

- SHFMU "Elena Gjika"
- SHFMU "Gjergj Fishta"
- SHFMU "AsimVokshi"
- SHFMU "Hilmi Rakovica"
- SHFMU "Zenel Hajdini"
- SHFMU "Shkolla e Gjelbër"
- SHFMU "Nazim Gafurri"
- SHFMU "Pjetër Bogdani"
- SHFMU "Qamil Batalli"
- SHFMU "7 Marsi"
- SHFMU "Emin Duraku"
- SHFMU "Andon Zako Cajupi"
- SHFMU "Nexhmi Mustafa"
- SHFMU "Dardania"
- SHFMU "Xhemail Mustafa"
- SHFMU "Hasan Prishtina"
- SHFMU "Mitrush Kuteli"
- SHFMU "Ismail Qemali"
- SHFMU "Shkëndija"
- SHFMU "Afrim Gashi"
- SHFMU "Mehmet Gjevori"
- SHFMU "Dituria"
- SHFMU "Ali Kelmendi"

- SHFMU "NaimFrashëri"
- SHFMU "Xhavit Ahmeti"
- SHFMU "GanimeteTërbeshi"
- SHFMU "Teuta"
- SHFMU "Pavarësia"
- SHFMU "Faik Konica"
- SHFMU "Avni Rrustemi"
- SHFNU "Nexhmi Mustafa"
- SHFMU "Fan Noli"
- SHFMU "Ditët e Minatorit"
- SHFMU "Filip Shiroka"
- SHFMU "Meto Bajraktari"
- SHFMU "Nëna Terezë"
- SHFMU "Azemi e Salihu"
- SHFMU "Dëshmorët 1921"
- SHFMU "Rilindja"
- SHFMU "Tefik Çanga"

Institucionet parashkollore

- IP "Yllkat"
 - IP "Xixëllonjat"
 - IP "Buzëqeshja"
 - IP "Fatosat"
 - IP "Lulevera"
 - IP "Gëzimi Ynë"
 - IP "Ardhmënia"
 - IP "Dielli"
-
- Koordinim me shkollat profesionale për sigurimin e punës praktike për nxënës;
 - Pajisja me polica të sigurimit ndaj aksidenteve për nxënësit e shkollave profesionale gjatë punës praktike;
 - Trajnime për nxënësit në Qendrën e Karrierës, të cilët do të fillojnë punën praktike;
 - Përgatitja e dokumentacionit për ndërtimin e objekteve dhe anekseve të shkollave të reja;
 - Planifikimi për fillimin e punëve për ndërtimin e shkollës "NënaTerezë";
 - Takim koordinues me donatorë për fillimin e ndërtimit të shkollës "7 Shtatori", si bashkëfinancues.

- Komisioni për shqyrtimin e ankesave të bursave komunale për studentë ka konstatuar se prej gjithsej tridhjetë e shtatë (37) ankesave, vetëm gjashtë (6) prej tyre kanë përfituar bursën në bazë të kritereve të parapara të konkursit.
- Policia e Kosovës, saktësisht DRP-Prishtinë, në fushën e bashkëpunimit në nivel lokal ka paraparë edhe mbajtjen e ligjëratave për shkolla të ciklit të ulët dhe të mesëm me tema aktuale “ Pasojat e narkotikëve, ngacmimet, trafikimi me qenie njerëzore, rregullat e komunikacionit, si dhe tema të ndryshme në interes të nxënësve. Ligjëratat do të organizohen gjithnjë duke respektuar masat e vendosura nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës në luftimin e pandemisë COVID-19.
- Vizitë në shkollën Faik Konica për të parë për së afërmi punimet në rregullimin e oborrit të shkollës ku është planifikuar të bëhen investime në infrastrukturë të shkollës.



- Vizitë në shkollën “Shkolla e Gjelbër” për Ditën e Tokës, në kuadër të këtij aktiviteti qendror për ditën e Tokës, Green Art Center-Prishtina me vullnetarët e saj dhe nxënësit e Klubit të gjelbër, promovuan rëndësinë për kujdes ndaj tokës, rëndësinë e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme, realizuan aksion pastrimi dhe mbjellje, në bashkëpunim me rrjetin botëror të organizatave që shënojnë Ditën e Tokës. Znj. Shpresa Shala, drejtoreshë e DKA-së në Komunën e Prishtinës theksoi se janë të angazhuar që të pasurojnë përmbajtjen ekstrakurrikulare përbrenda sistemit të arsimit.



- Takim me Federatën e Notarëve, më 16.04.2021;
- Takimi i radhës i Këshillit Drejtues të ADSHKP-së;
- Takim me Zyrën e burimeve njerëzore, më 20.04.2021;
- Planifikimi i trajnimit për udhëheqësit e institucioneve edukativo-arsimore, tema: “Planifikimi i buxhetit të institucioneve edukativo-arsimore”;
- Takim me ekspertë për evaluimin e programit të Turkologjisë, më 15.04.2021;
- Takim me KEPSH, më 23.04.2021;
- Takim me organizatën WISEWORD KOSOVA, më 26.04.2021;
- Takim me Agon Jusufin – “LuxDev” dhe Nazmije Torën lidhur me ndërtimin e shkollës, më 27.04.2021;
- Vizitë në SHFMU “Faik Konica” - Procesi final i trajnimit “Vlerësimi i Brendshëm i Performancës së Shkollës”;
- Global Cities- MeganWilhelm, Labinot Salihu, më 28.04.2021;
- Takim për udhëzuesit e përkohshëm – MASHT, më 15.04.2021;
- Gjatë muajit prill 2021, ekipi vlerësues për nxënës me nevoja të veçanta I Komunës së Prishtinës, ka bërë vlerësimin e nxënësve.

- Takimi me Komitetin Drejtues të Asociacionit të Drejtorëve, më 24 prill 2021, ku u diskutuan: kompensimi i orëve të humbura do të mbahet më/përgjatë a) dy ditëve të shtuna - 8 (me orar të së hënës) dhe 22 maj (me orar të së martës), b) në fund të vitit shkollor - 4 ditë mësimi më shumë (me orar të së mërkurës, e tutje). Diskutime për trajnimet: a) Procesi final për "VBSH", b) "Vlerësimi për shkallë". Gjithashtu u diskutua për mësimin plotësues, ku mësimi plotësues është mbajtur nga shkollat tona, tashmë do të vazhdohet në bazë të rekomandimit/vendimit të MASHTI-t, me nga 1 orë në javë për lëndë, do të fillohet nga data 3 maj 2021, andaj duhet të jemi të përgatitur, si: a) planifikimin (sa nxënës, emrat e nxënësve, për cilat rezultate planifikohet të punohet etj.), b) raportet e punës do të dërgohen çdo (dy) javë nga mësimdhënësit në drejtoritë e shkollave, pastaj prej shkollave në DKA, pastaj në MASHT.



- Më 27 prill, përfundoi procesi final i trajnimit për Vlerësim të brendshëm të shkollës, trajnim i cili u realizua në dy grupe në dy shkolla: në SHFMU "Faik Konica" dhe SHFMU "Qamil Batalli". Në këtë punëtori kanë marrë pjesë 27 shkolla fillore, të ndara në dy grupe, ku për secilën shkollë kanë qenë pjesëmarrës drejtori i shkollës dhe koordinatori i cilësisë. Procesi final i Trajnimit të Vlerësimit të Brendshëm të Performancës së Shkollës, ku përmes prezantimeve kishin për detyrë të sqarojnë dhe të raportojnë për punën praktike në shkollë/terren. Trajnerët dhe kolegët e shkollave të tjera dhanë informata kthyesë dhe diskutuan për fushat e ndryshme të cilësisë, e gjithashtu edhe për planin orientues deri në përfundimin praktik të të gjitha fushave brenda këtij formati. Zyrtarët komunalë dhe trajnerët e këtij programi, përkrahën procesin duke mentoruar dhe lehtësuar procesin për hapat në vazhdim.



- Punëtori dyditore në Prevallë, të organizuar nga Caritasi zviceran, me temën “Rrjetizimi i edukatorëve”;
- Realizimi i vizitave në shkollat fillore me përfaqësuesit e Caritasit zviceran nga projekti “Shpresë”, lidhur me inventarizimin e klasëve parafillore;
- Vizita u realizua në këto shkolla fillore: SHFMU “Ismail Qemali”, SHFMU “Hasan Prishtina”, SHFMU “Dardania”, SHFMU “Faik Konica”, SHFMU “Nazim Gafurri”, SHFMU “Iliria”, ku qëllimi i vizitave ka qenë vlerësimi i klasëve parafillore, matja, inventarizimi i tyre me të gjitha kërkesat e një klase parafillore;
- Gjatë muajit prill 2021, janë ndarë 35 pako higjienike për fëmijët me nevoja të veçanta, të cilat janë dhuruar nga organizata “Save the Children”.

Përgatitjet për organizimin e Testit të arritshmërisë 2021

Testit të arritshmërisë i nënshtrohen të gjithë nxënësit të cilët kanë përfunduar klasën e 9-të në shkollat e Republikës së Kosovës. Nga testi i arritshmërisë lirohen nxënësit me nevoja të veçanta, të cilët janë arsimuar me Plan Individual të Arsimit (PIA) dhe ata me fusha të aktiviteteve.

Testi i arritshmërisë 2021 do të mbahet më 21 maj 2021, në të njëjtën kohë për të gjithë nxënësit. Në kushte të pandeminë dhe në përputhje me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), Testi i arritshmërisë do të organizohet në atë mënyrë, që të ketë numër sa më të vogël të nxënësve brenda një qendre të testimit dhe brenda klasave të testimit në të njëjtën kohë. Në Komunën e Prishtinës Testi i arritshmërisë 2021 do të organizohet në nëntëmbëdhjetë qendra testuese, ku testit do t'i nënshtrohen gjithsej 3320 nxënës.



Organizimi i testit ndërkombëtar PISA 2022

Programi për vlerësim ndërkombëtar të nxënësve, i njohur si PISA, është projekt i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), i cili mbahet çdo tri vite.

PISA u organizua për herë të parë në vitin 2000, ku morën pjesë 43 shtete, ndërsa në vitin 2018 u mbajt cikli i shtatë i këtij testi, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga 80 shtete. PISA nuk analizon vetëm nëse nxënësit kanë mësuar atë që ju është ligjëruar, por gjithashtu vlerëson nëse studentët mund të përdorin në mënyrë kreative dhe kritike atë që dinë. Pra, ky studim mundëson krahasimin ndërkombëtar të vlerësimit të arritjes së studentëve, vlerëson dijen e lidhur me situata reale, ashtu si përgatitjen edhe aftësitë për pjesëmarrje në shoqëri. PISA ndihmon qeveritë të krijojnë politika efektive arsimore, duke u bazuar në rezultatet e këtij studimi. Nga secili shtet që merr pjesë në PISA, përzgjidhet një mostër reprezentative e nxënësve 15-vjeçarë që t'i nënshtrohen testit. Prandaj, konsiderohet se rezultatet reflektojnë gjendjen reale të sistemit të arsimit dhe mundësojnë krahasimin në mes të shteteve. Kjo matje bëhet në tri disiplina/fusha: lexim, matematikë dhe shkencë të natyrës. Në Komunën e Prishtinës testi PISA 2022 është organizuar në dy qendra të testimit, ku në testim morën pjesë gjithsej 336 nxënës të shkollave të mesme të larta.



Organizimi i testit PIRLS 2021

Procedimi i të dhënave për shkollat e përzgjedhura për vlerësimin ndërkombëtar PIRLS 2021, i cili do të mbahet me nxënësit e klasave IV vetëm në një lëndë, në lëndën e gjuhës amtare (shqipe), i cili planifikohet të mbahet në qershor 2021. Nga shkollat e pjesëmarrëse është bërë përzgjedhja e klasave pjesëmarrëse të cilat do të testohen.

Procedimi i lëndëve në departamentin e prokurimit për shpallje të kërkesave të institucioneve sipas planit të prokurimit 2021.

- ***AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:***
- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkolla;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të brendshëm;
- Kontraktimi i një operatori ekonomik për furnizim me mjete kundër COVID-19;

- Kontraktimi i operatorit ekonomik për furnizim me drurë dekorativë dhe gjelbërimin e oborreve;
- Kontraktimi i operatorit ekonomik për furnizim me inventar;
- Kontraktimi i operatorit ekonomik për furnizim me material higjienik;
- Kontraktimi i operatorit ekonomik për furnizim me material didaktik;
- Kontraktimi i operatorit ekonomik për organizimin e transportit të nxënësve.

4.1.1. STATISTIKAT

-Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

4.1.2 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

| Buxheti i shpenzuar dhe i alokuar | | | | |
|--|---------------|-----------------|------------------------|-------------------|
| Kategoria eko. | Alokim | Shpenzim | Zotim - Obligim | Mbetje -S= |
| Paga | 1,569,594.67 | 1,569,594.67 | | |
| Komunali | 380,000.02 | 317,255.87 | 12,197.21 | 50,546.94 |
| 10-MSH | 1,258,900.03 | 961,037.16 | 135,986.50 | 161,876.37 |
| 21-MSH | | | | |
| Subvencione | 200,000.00 | 84,340.00 | | 115,660.00 |
| Donacione | 76,256.62 | 20,911.90 | | 55,344.72 |
| FB-21-Kapitale | 1,430,000.00 | 245,763.41 | 286,620.60 | 897,615.99 |
| FB-22-Kapitale | | | | |
| Gjithsej: | 4,914,751.34 | 3,198,903.01 | 434,804.31 | 1,281,044.02 |

4.1.3 Takimet me palë

Drejtorja e Arsimit, gjatë muajit prill të vitit 2021, ka realizuar mbi 70 takime me palë. Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

5. *Takimet me institucione të tjera*

- Takim me përfaqësuesit e MASHT-it për përgatitjen e testit PISA 2022;
- Takim me përfaqësuesit e MASHT-it për përgatitjet e Testit të arritshmërisë 2021;
- Takim me përfaqësuesit e MASHT-it, Zyrën rajonale DVSCS rreth organizimit të testit ndërkombëtar PIRLS2021;
- Takim me koordinatorët e shkollave për organizimin e testit PISA2022;
- Takim me koordinatorët e shkollave përkatëse për organizimin e testit PIRLS2021.

5.1.1 *Diskutime publike/takimet me qytetarë*

6. *Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare*

Gjatë muajit prill 2021, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

6.1.1 *Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër*

- 7 Gjatë muajit prill të vitit 2021, janë pranuar gjithsej 108 lëndë, prej tyre të miratuara janë 5, të refuzuara 3, të pezulluara 4 dhe në proces janë edhe 96.

8. *Takime të tjera*

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takim me drejtueset e IP;
- Takim me përfaqësueset e edukatoreve në institucionet parashkollore;
- Takime me prindër dhe mësime të tjerë.

9. *SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutemi shpjegoni në këtë hapësirë.*

- Stafi i reduktuar për shkak të pandemisë COVID-19;
- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafi profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjorë në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Implementimi i kurrikulës së re;
- Puna e shumicës së shkollave me katër ndërresa, për shkak të ndarjes së klasës në dy pjesë, për të respektuar masat kundër pandemisë COVID- 19;

- Vështirësitë dhe pa mundësia e zëvendësimit të mësimdhënësve të infektuar dhe me sëmundje kronike;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimi në distancë (online);
- Mungesa e pajisjeve teknologjike për nxënës dhe mësimdhënës.

10. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësive, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit.

11. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja, mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit të (DKA-së shkollë), dhe mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Hartimi i politikave dhe rregulloreve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
- Organizimi i punëtorëve të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave, sfidave, vështirësive, pengesave;
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Organizohen takime dhe punëtori për ndarje të përvojave dhe praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re;
- Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikimi i nevojave të shkollës për mjete të TIK-së;

- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë, kabinete dhe materiale shpenzuese gjatë vitit;
- Hartimi i listave për nevojat e secilës shkollë për punëtori, kabinete, laboratorë dhe materiale shpenzuese;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave monitorues për përdorimin e kabineteve;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, ReggioEmilia, Hap pas hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës etj.) për organizimin e mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – në të përfshihen edhe profesionistë – ekspertë);
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH-së;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT-in dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2020/2021, dhe konsultime me MASHT-in;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtë kurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA-ja përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonim;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA-ja harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë, për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimi nëpër shkolla;

- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

12. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.